



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
**Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Autoriteti i Konkurrencës  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority  
Nr. i Prot./Br. Prot./Prot. No. 823/24-M/D  
Nr. i Fq./Br. St./No. Pg. 1/3  
Data/Exitum/Date: 24.12.2024  
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

**Vendimi: Nr. 110/24**  
**Datë: 24.12.2024**

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe nenin 55 nën paragrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-056, Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023, Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Përkatës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, pas Shqyrtimit të Raportit të Sekretariatit në mbledhjen e datës, 24.12.2024, mori këtë:

### V E N D I M

- I. LEJOHET, Përqendrimi i ndërmarrjeve, lidhur me blerjen e 51% të aksioneve dhe marrjen kontrollit të drejtpërdrejtë, nga ndërmarrja ALPE GEF ZOB d.o.o. mbi Ortho Dental d.o.o.;
- II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim, obligohet të paguajë taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (një mijë euro), dhe Vendimin për Realizimin e Përqendrimit, në përputhje me nenin 55, paragrafi 1.5 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

### Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 26.11.2024, me Nr. Prot. 749/24-1 1/H, ka pranuar kërkesën për Njoftim të Përqendrimit, përmes z. Korab Rexhepi - Përfaqësues Ligjor, lidhur me blerjen e 51% të aksioneve dhe marrjen kontrollit të drejtpërdrejtë, nga ndërmarrja ALPE GEF ZOB d.o.o. mbi Ortho Dental d.o.o..

### Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e dorëzuar, me datë: 10.12.2024;
2. Njoftimi për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së, me datë: 11.12.2024;

U.P.B

J.M.

JGL

## Baza Ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 13, të Ligjit 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimi për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

1. Qarkullimi i palëve në tregun ndërkombëtar e kalon shumën 20,000,000 Euro;
2. Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumën 1,000,000 Euro;
3. Marrëveshja për Blerjen e Aksioneve.

**ALPE GEF ZOB d.o.o.**, është e regjistruar sipas ligjit të Republikës së Sllovenisë, me seli në Verovškova ulica 55A, Lubjanë, 1000, Slloveni, me numër regjistrimi 9085220000. E njëjta operon, në tregun e menaxhimit të investimeve dhe zotërimit të aksioneve në ndërmarrje të tjera. Kjo ndërmarrje është nën kontrollin e ndërmarrjes ALFI SKLADI d.o.o., e cila poashtu ushtron veprimtarinë e menaxhimit të fondeve dhe ka në menaxhim asete në vlerë të më shumë se 500 milionë euro. ALFI SKLADI është e fokusuar në investime, kryesisht në republikën e Sllovenisë, Kroacisë, me një fokus dytësor në Serbi, Maqedoni të Veriut, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Mal të Zi, (blerësi).

**OrthoDental d.o.o.**, është e regjistruar sipas ligjit të Republikës së Sllovenisë, me adresë në Vilharjeva cesta 42, 1000, Slloveni, Lubjanë, me numër regjistrimi: 8162158000. E njëjta, është klinikë dentare në Lubjanë, e cila ofron kujdes gjithpërfshirës dentar, duke u bazuar në teknologjinë moderne, me përvojë në trajtimin ortodontik, implantologjik dhe stomatologji estetike. Këto shërbime ofrohen në selitë në Lubjanë, Maribor, Kozin dhe Celje. Kjo ndërmarrje nuk operon dhe nuk ka filiale në Republikën e Kosovës, (shitësi).

### Tregu përkatës:

**Tregu i produktit:** Tregu i ofrimit të shërbimeve të kujdesit dentar.

**Tregu gjeografik:** Tregu i Republikës së Sllovenisë.

**Analiza e Konkurrencës:** Palët në përqendrim, nuk veprojnë në treg të njëjtë të produktit, nuk kanë filiale e as nuk synojnë që ta shtrijnë aktivitetin ekonomik në Kosovë. Andaj përqendrimi, nuk do të ketë efekt për shtetasit e Kosovës, pasi ky transaksion, nuk rezulton në mbivendosje horizontale apo marrëdhënie vertikale ndërmjet aktiviteteve të palëve, duke eliminuar kështu çdo shqetësim të mundshëm për konkurrencën. Angazhimi në aftësimin e profesional të specialistëve të ortodencisë, implantologjisë dhe stomatologjisë estetike në Kosovë, si dhe zhvillimi i teknologjisë, ka bërë që ky treg të zhvillohet në Kosovë krahasuar me dekada më parë. Në Republikën e Kosovës operojnë një mori ordinancash stomatologjike, që përpos kujdesit dentar, ofrojnë dhe shërbime ortodontare, implantologjike dhe të stomatologjisë estetike, gjë që e bën këtë treg goxha konkurrues në Kosovë. Prandaj ky treg nuk është treg i koncentruar dhe si i tillë nuk ngritë ndonjë shqetësim për konkurrencën dhe konsumatorët. Përqendrimi në fjalë do të ketë efekte pozitive, në fushën e ofrimit të shërbimeve dentare për shtetasit e Sllovenisë, respektivisht do iu ofrojë atyre zgjedhje më të madhe të ordinancave që ofrojnë shërbime të tilla.

P.B

J.M.

SGL

## Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për shkak se njëra palë në transaksion, gjeneron të ardhura në Kosovë përmes ndërmarrjeve të treta. Struktura e tregut të ndërmarrjes blerëse, në tregun e Republikës së Kosovës nuk do të ndryshojë. Transaksioni i propozuar nuk paraqet shqetësime për konkurrencën dhe nuk pritet të ndikojë në konkurrencën në Kosovë, në krijimin apo forcimin e pozitës dominuese. Për më tepër, objekti i kontratës, nuk është i lidhur drejtpërdrejt me tregun përkatës të Republikës së Kosovës, duke e bërë të pamundur që ky transaksion të ndihmojë në krijimin e ndonjë disavantazhi konkurrues në këtë treg. Divizioni i Përqendrimeve ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencën, respektivisht ky transaksion/blerja, nuk do të ndikojë në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët, përkatësisht objekti i kontratës nuk korrespondon, me tregun përkatës të Republikës së Kosovës.

### Shënim:

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti-konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës të Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij Propozim Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë.


## AUTORITETI I KONKURRENCËS KOMISIONI

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare



Kaltrina Sela  
Nënkryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare



Florent Mehmeti  
Anëtar



Salihe Gashi-Loku  
Anëtare



III. Me këtë Vendim, të njoftohen:

- Palët
- Arkiva